



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 05.04.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“WEST HILL”, KOMPLEKS TURISTIK (VILA, APART/HOTEL DHE**  
**RESTORANT ZONA A-F / VILA ZONA G), ME VENDNDODHJE NË DHËRMI,**  
**BASHKIA HIMARË**

Në mbështetje të neneve, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese “Egeu Stone” sh.p.k, “Adel” sh.p.k dhe “Immo Invest” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “West Hill”, Kompleks Turistik (Vila, Apart/Hotel dhe Restorant\_Zona A-F / Vila\_Zona G), me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Egeu Stone” sh.p.k, “Adel” sh.p.k dhe “Immo Invest” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR/SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26/11 / 2024